



GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
DHOMA PENALE

Rr Jordan Misja, Tiranë, web: www.gjykatatirana.gov.al

Nr. Regj. SP. 1446 /Nr. Regj. Them 21.04.2022
Dt. Regj. SP. 18.03.2022/ Dt.Regj.Them 21.04.2022

Numër 1330 Vendimi
Datë 13.05.2022 Vendimi

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE - MIGENA LASKA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ornela ONJEA**, pasi shqyrtoi në seancë gjyqësore, në prani të palëve, çështjen penale që i përket :

KËRKUES: **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e përfaqësuar nga prokurore, **Znj. Miranda Bushi**.

TE PANDEHUR: 1. **Albert Duka**, verifikuar identiteti me anë të sistemit TIMS me nr personal H80829023, i biri i Ismail dhe Besnike, i dtl. 28.08.1978, lindur dhe banues në Tiranë, Fshati Skrep, Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë, me arsim 8 vjecar, beqar, i padënuar me parë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare.

Hetuar me masë sigurimi **“Arrest në burg”** caktuar me vendimin Nr. 1537 Akt datë 06.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar në masën e sigurimit **“Arrest në shtëpi”** caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr. 856 datë 21.09.2021, zëvendësuar me masën e sigurimit **“Detyrimi për t’u paraqitur pranë policisë gjyqësore”** caktuar me vendimin Nr. 1537/1 Akti datë 15.12.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

I mbrojtur nga **Av. Odeta Taçi**, me nr Liç 11210, NIPT L91713014J, Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr cel 069606005, dhe **Av . Melina Gjeta**, me nr lic 1068, NIPT L91713014J, Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, të zgjedhura me deklaram në seance, nga vetë të pandehurit.

2. **Jashar Duka**, verifikuar identiteti me anë të kartës ID me nr personal F90412041H, i biri i Eshref dhe Hidushe, i dtl. 12.04.1959, lindur dhe banues në Tiranë, Fshati Skrep, Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë, me arsim 8

vjecar, i martuar, me 3 fëmijë, i padënuar me parë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me nr cel 069 24 04 912.

I mbrojtur nga **Av. Odeta Taçi**, me nr Liç 11210, NIPT L91713014J, Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr cel 069606005, dhe **Av . Melina Gjeta**, me nr lic 1068, NIPT L91713014J, Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, të zgjedhura me deklaram në seance, nga vetë të pandehurit.

Hetuar me masë sigurimi "**Arrest në burg**" caktuar në vendimin Nr. 1537, datë 06.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar në "**Arrest në shtëpi**" nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr. 856 Vendimi datë 21.09.2021.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale të "**Kultivimi i bimëve narkotike**" parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 284/1 i Kodit Penal.

Gjykata, pasi dëgjoi Prokuroren e çështjes **Miranda Bushi**, e cili përfundimisht kërkoi:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit Albert Duka për kryerjen e veprës penale të "Kultivimi I bimëve narkotike", veprë kjo e parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 6 vite burgim.*
- *Mbi bazën e nenit 406 të K.Penal dënimin e tij me 4 vjet burgim.*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurit Jashar Duka për kryerjen e veprës penale të "Kultivimi i bimëve narkotike", veprë kjo e parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 6 vite burgim.*
- *Mbi bazën e nenit 406 të K.Penal dënimin e tij me 4 vjet burgim.*

Shpenzimet procedurale në ngarkim të të pandehurve.

Si dhe pasi dëgjoi të pandehurin dhe avokatin mbrojtës të cilët kërkuan:

- *"Një dënim sa më të butë për të mbrojturit prej meje Albert Duka dhe Jashar Duka. Këta shtetas janë në një gjendje tepër të rënduar ekonomike. Një shtetas u ka kërkuar për ti punësuar për tu kujdesur për disa bimë, punë për të cilën do paguheshin dhe me të ardhurat do siguronin të ardhmen e familjes. Nuk e kanë ditur që ishin bimë narkotike. Familja e Jashar Dukës trajtohet me ndihmë ekonomike. Bashkëshortja e Jasharit vuan nga problem të rënda shëndetësore. Rrezikshmëria shoqërore është e tillë që nuk e bën të nevojshëm izolimin e tyre nga shoqëria, atyre u duhet të kujdesen për familjet e tyre. Jetojnë në kushte miserabël, nuk kanë as një cati në shtëpinë e tyre. Për këtë arsye kërkojmë një dënim sa më të butë për të dy të mbrojturit prej meje dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë."*

Dhe pasi administroi provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata,

V Ë R E N :

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ardhur për shqyrtim gjyqësor çështja penale e sipërcituar.

I. PROCEDURA:

Gjykata çmon se bazuar në nenet 69, 74, 76, 332/c, pika 3 dhe 332/dh, pika 1, gërma c) të KPP, ka juridiksion dhe kompetencë lëndore e tokësore për shqyrtimin e kësaj kërkesë penale. Gjykata, gjithashtu, konstatoi kryesisht se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie për gjykimin e kësaj çështjeje.

Bazuar në kërkesën e të pandehurit, të kryer që në seancë paraprake, përpara kësaj Gjykate, në zbatim të neneve **332/c/dh/e/ë të K.Pr.Penale**, ndryshuar me nenin 17 të ligjit **nr. 41, të vitit 2021**, si dhe bazuar në **nenin 403 - 405 të K.Pr.Penale**, Gjykata, pasi e çmoi të mundur shqyrtimin e plotë dhe të drejtë të kësaj çështjeje në gjëndjen në të cilën ndodhen aktet, vendosi të pranojë kërkesën për "**Gjykim të Shkurtuar**".

Kjo gjykatë, duke çmuar se çështja mund të zgjidhet drejt dhe objektivisht në gjëndjen në të cilën ndodhen aktet, dhe duke qenë se vepra penale nuk është nga ato vepra për të cilat nuk lejohet gjykim i shkurtuar dhe bazuar në nenet 332/c, pika 3, 332/dh/1/c) në lidhje me nenet 403 - 405 të K.Pr.P, vendosi të pranoi kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, duke vendosur kalimin e çështjes penale për gjykim themeli në seancë gjyqësore.

Në kushtet kur gjykata pranoi kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar vendosi të bëjë pjesë të fashikullit të gjykatës, fashikullin e hetimeve paraprake të procedimit penal dhe në referim të nenit 332/dh/1/c) K.Pr.P, ftoi palët në paraqitjen e diskutimeve përfundimtare të cilat parashtruan si më sipër.

II. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

Se në datën 11.06.2021 nga ana e shërbimeve të policisë pranë Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë, në kuadër "Planit të masave për kontrollin e territorit për bime narkotike të llojit "Canabis Cativa", gjatë kontrollit të territorit, në vendin e quajtur "Majlug", e cila ndodhet në territorin e fshatit Skrep të Njësisë Administrative Shëngjergj - Tiranë, në një pjesë të shpyllëzuar janë gjetur të mbjella **35 (tridhjetë e pesë) bimë** të dyshuara si bimë narkotike të llojit "Canabis Cativa".

Nga këqyrja e vendit të ngjarjes është konstatuar një sipërfaqe toke e shpyllëzuar, e cila ishte e rrethuar nga të katër anët me shkurre të llojit "shkoze" dhe ishte në një terren të pjerrët.

Nga këqyrja e këtij vendi, vërehet se pjesa e shpyllëzuar ishte rreth 50m2 ku vërehen se janë kultivuar **35 (tridhjetë e pesë) rrënjë** bimë me ngjyrë jeshile të ngjashme me atë të bimës

narkotike të llojit "Canabis Cativa", të cilat kishin lartësi më e vogla **5 cm** dhe më e madhja **10 cm** nga toka.

Keto bimë ishin të kultivuara në gropa, të cilat kishin largësi rreth 1 metër larg njëra - tjetrës.

Nga këqyrja e mëtejshme e vendit të ngjarjes u konstatua se në anën lindore të kësaj parcele ishte shtrirë një tub llastiku me ngjyrë të zezë, i cili vinte nga një përrua që ndodhej pranë vendit ku u konstatuan bimët.

Kjo sipërfaqe gjendet në pjesën jugore të fshatit Skrep të Njësise Administrative Shëngjergj - Tiranë dhe ka koordinata 41°19'01.25" N 2°07'53" E.

Nga informacionet e siguruar në rrugë operative është bërë e mundur identifikimi dhe dokumentimi i personave që dyshohej si autorë të mundshëm në këtë aktivitet kriminal, të cilet janë shtetasit Jashar Duka dhe Albert Duka.

Nga ana e policisë gjyqësore është bërë ndalimi me iniciativë i shtetasit Albert Duka dhe Jashar Duka, nëpërmjet procesverbalit për ndalimin e të dyshuarit për një krim datë 03.09.2021, ndalim ky që është vleftësuar i ligjshëm me vendimin nr. 1537 akti datë 06.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka caktuar edhe masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues "**Arrest në burg**" ndaj shtetasit Jashar Duka dhe Albert Duka, **masa sigurimi të cilat janë ndryshuar e më pas edhe zëvendësuar me vendimet gjyqësore të cituara në pjesën hyrëse të këtij vendimi të arsyetuar.**

Nga ana e Prokurores është nxjerrë Autorizimi për lejimin e vezhgimit të vendeve publike, regjistrimin fotografik dhe filmik datë 12.08.2021, nëpërmjet të cilit u autorizua përgjimi i fshehtë fotografik, filmik me video i personave të dyshuar si autorë të veprave penale të procedimit 4594 të vitit 2021.

I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, nëpërmjet procesverbalit datë 08.08.2021, shtetasi **Albert Duka ka deklaruar se e ka kryer veprën për shkaqe ekonomike, pasi nuk ka të ardhura të tjera financiare.**

Ai ka deklaruar se kjo është hera e parë që merret me kultivimin e bimëve narkotike dhe se ndjehet i penduar.

I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, nëpërmjet procesverbalit datë 08.08.2021, shtetasi **Jashar Duka** ka deklaruar se e ka kryer **veprën për shkaqe ekonomike, pasi ka të sëmurë bashkëshorten e tij, e cila vuan nga zemra dhe ka bërë operacion në sy.**

Ai ka deklaruar **se ndihet i penduar** për veprimet që ka kryer.

Nëpërmjet procesverbalit datë 03.09.2021, shtetasi Jashar Duka kanë dhënë deklarime me vetpërgjegjësi, duke deklaruar se veprën penale e ka kryer për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike.

Nëpërmjet procesverbalit date 03.09.2021 për deklarimin me vetëpërgjegjësi, shtetasi Arbert Duka ka deklaruar se e njeh shtetasin Jashar Duka, pasi kanë banesat afër në të njëjtën lagje.

Ai ka deklaruar se duke qënë në kushte shumë të vështira ekonomike dhe pa punë, i shkoi mëndja të merrte rrezikun e të kultivonte lëndë narkotike së bashku me shtetasin Jashar Duka, i cili i ofroi mundësinë që të mbillnin të dy canabis, pasi kishte siguruar disa fara canabis.

Duke qënë se kishin nevojë për lekë të dy bashkë shkuan dhe i mbollën rreth 35-40 rrënjë ne anë të majtë të një përroi në vendin e quajtur "Majlung", në zone pyjore rreth datës 20.05.2021.

Ai ka deklaruar se farat i mbolli direkt në tokë, fillimisht gropat i plerova me ple organik, të cilin e morri tek stanet me kalin e bashkëfshatarit të tij Jashar Duka dhe me pas mbolli farat.

Ai ka deklaruar se gropat o hapi bashkë me Jasharin dhe në parcele ka shkuar shume rrallë, një herë në dy, tre javë.

Për t'i vaditur gjeti një copë zorre plastike në ngjyrë të zezë rreth 30-40 cm të gjatë, e vuri në përrua për vaditje dhe për ti vaditur e prashitur bimët e ka ndihmuar edhe bashkëfshatari i tij Jashar Duka dhe janë kujdesur të dy.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi **Gazmend Duka** ka deklaruar se ai banon me familjen e tij dhe vëllain Albert Duka.

Ai ka deklaruar se nuk ishte në dijeni se vëllai i tij ishte i përfshirë në këtë aktivitet dhe se e ka mësuar kur ka ardhur në polici, sepse po ta dinte këtë gjë nuk do e lejonte vëllain e tij të kryente këto veprime.

Ka deklaruar se nuk ka vënë re ndonje gjë të dyshimtë pasi vëllai i tij shkonte shpesh në pyll, pasi mblidhte kërpudha dhe këtë e dinë të gjithë në fshat. Ai nuk ka parë në asnjë rast që vëllai Alberti të shoqërohej me Jashar Duka, të cilin edhe ai e njeh pasi banojnë në të njëjtin fshat.

Ai nuk ka dijeni se kush i ka patur farat e bimëve narkotike dhe nuk ka dijeni se kush persona merren me kultivimin e këtyre bimëve.

Nga ana e policisë gjyqësore është bërë sekuestrimi i aparatit telefonik celular "Samsung" të shtetasit Jashar Duka dhe aparatit telefonik "Nokia" të shtetasit Albert Duka, me procesverbalin datë 03.09.2021.

Eshtë bërë kontrolli i vendit, banesa e shtetasit Albert Duka, nëpërmjet proces-verbalit datë 03.09.2021, nga ku ka rezultuar se nuk u konstatuan sende të kundërligjshme.

Eshtë bërë kontrolli i vendit, banesa e shtetasit Jashar Duka, nëpërmjet procesverbalit datë 03.09.2021, nga ku ka rezultuar se nuk u konstatuan sende të kundërligjshme.

Nga ana e policisë Gjyqësore u bë këqyrja e kamerës, datë 02.09.2021 e cila u shoqërua me fotografi kriminalistike, nëpërmjet të cilës janë konstatuar në këtë parcelë në kohë të ndryshme duke u shërbyer bimëve narkotike të dyshuara si "Canabis Cativa" duke kultivuar 35 bimë të tilla në vendin e quajtur "Majlug" me vendndodhje në territorin e Njësisë Administrative Shëngjergj - Tiranë.

Nga ana e policisë gjyqësore është bërë asgjësimi i proves materiale, ku 30 (tridhjetë) bimë te dyshuara si narkotike "Canabis Cativa" u zaszgësuan në vend me anë të zjarrit së bashku

me tubin e ujitjes, kurse 5 (pese) rrënjë bime janë marrë për ekzaminime të mëtejshme laboratorike dhe janë dërguar në Drejtorinë e Policisë Shkencore.

Eshtë marrë vendim datë 03.09.2021 për kryerjen e ekspertimit kimik.

Nëpërmjet aktit të ekspertimit nr. 9163 datë 15.09.2021 rezultoi se:

"Nga ekzaminimi makroskopik i bimeve objekt ekspertimi, rezulton se ato janë bimë *canabis sativa L*".

Nga ana e policisë gjyqësore është mbajtur procesverbali datë 03.09.2021 ora 17:30 për këqyrjen e jashtme të shtetasve Jashar Duka dhe Albert Duka.

Nga kontrolli personal i këtyre shtetasve, me procesverbalin datë 03.09.2021 rezultoi se shtetasit Albert Duka nuk i'u gjet gje me vete, ndersa shtetasit Jashar Duka i'u gjet karta e tij e identitetit.

Në datën 04.09.2021 është marrë Vendim për Bashkimin e Procedimeve, duke qënë se më parë ishte regjistruar procedimi penal për ngjarjen datë 11.06.2021, në këto kushte është vendosur bashkimi i procedimit 4594/2021 dhe nr. 5992/2021 dhe procedimi i ri i lindur ka marrë numrin 4594, pasi është regjistruar më parë.

Në përfundim, të pandehurit janë njohur me përfundimin e hetimeve në prani të mbrojtësit ku kanë deklaruar se nuk ka nevojë për kryerje të veprimeve të tjera hetimore.

Gjykata, pasi ka shqyrtuar objektivisht, të gjitha faktet, rrethanat dhe provat e administruara në seancë gjyqësore, provat shkresore, arrin në përfundimin se, jemi përpara konsumimit të veprës penale "**Kultivimi i bimëve narkotike**" parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, të kryer nga të pandehurit **Albert Duka** dhe **Jashar Duka**.

I. **BAZA LIGJORE E PALIKUESHME:**

Neni 284 K.Penal

Kultivimi i bimëve narkotike

(Ndryshuar paragrafi I dhe III, shtuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 66)

Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Organizmi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Elementet e konsumuar nga ky i pandehur, pjese perberese dhe ekzistenciale te kesaj vepre penale, rezultojne si me poshte:

- **OBJEKTI:** Veprimet e të pandehurit, kanë cënuar marrëdhëniet juridike, të cilat janë vendosur për të siguruar dhe garantuar mbarëvajtjen dhe ecurinë normale ne veprimtarine e organeve shteterore per ruajtjen e rendit dhe sigurise publike; ne respektimin dhe funksionimin e shtetit ligjor, konform rregullave dhe proceduriale ligjore përkatëse. Në

mbeshtetje edhe te akteve ndërkombetare, për të siguruar kontrollin mbi kultivimin e lëndëve narkotike.

- **ANA OBJEKTIVE**: Kjo veper penale, është konsumuar nga të pandehurit me veprime konkludente, duke kultivuar bimë narkotike, të dëmshme për jetën dhe shëndetin, si dhe të palejuara nga ligji; përdorimin e të cilave ligjvënësi e ndalon me ligj, duke e konsideruar fakt penal, të parashikuar e të sanksionuar në kodin penal shqiptar.
- **SUBJEKTI**: Gjykata, konstaton se moshë mbi 14 vjeç, si dhe përgjegjshmëria e të pandehurve, i bën ata të jenë të përgjegjshëm përpara kritereve ligjore për të mbajtur përgjegjësi për këto veper penale.
- **ANA SUBJEKTIVE**: Nga ana subjektive veprimet e të pandehurve janë kryer me dashje direkte.

III **CAKTIMI I DËNIMIT**

Neni 47 Kodi Penal

Mënyra e caktimit të dënimit

Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale.

Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Neni 48 Kodi Penal

Rrethanat lehtësuese

(Shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, neni 5)

Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë:

- a) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore;*
- b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër;*
- c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit; ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë;*
- d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale;*
- dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale;*
- e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar. Rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer në rrethanat e parashikuara në shkronjën “j” të nenit 50 të këtij Kodi. Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.*

Neni 49 Kodi Penal

Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethanat të tjera për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

Neni 50 Kodi Penal

Rrethanat rënduese

(Ndryshuar shkronja “b”, shtuar shkronja “h” dhe “i” me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 5; ndryshuar shkronja “dh” me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 8; shtuar shkronja “j” me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, neni 6; shtohet shkronja “ç/1” dhe “e/1” dhe ndryshohet shkronja “g” dhe “j” me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, neni 6)

Rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë:

- a) kryerja e veprës i shtyrë nga motive të dobëta;
- b) kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo për të shmangur dënimin për një veprë penale tjetër ose për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material;
- c) kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori;
- ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë;
- ç/1) kryerja e veprës penale pas vendosjes së personit nën mbikëqyrje elektronike;
- d) kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale;
- dh) kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar;
- e) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
- e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;
- f) kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera;
- g) kur vepra është kryer duke përfutuar nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes;
- gj) kryerja e veprës penale në bashkëpunim;
- h) kryerja e veprës penale më shumë se një herë;
- i) kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive.
- j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, bazuar dhe në parashikimin ligjor të nenit **47 i Kodit Penal**, i cili parashikon se: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.

Në interpretim literal të dispozitës së mësipërme, gjykata konkludon se në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, gjykata duhet të vlerësojë këto elementë:

- a) Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal;
- b) Rrezikshmërinë e veprës penale;
- c) Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale;
- ç) Shkallën e fajit;
- d) Rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Parimi i individualizimit të dënimit, përbën një nga parimet themelore të këtij instituti të së drejtës penale. Ligjvënësi në individualizimin ligjor udhëhiqet në mënyrë abstrakte nga rrezikshmëria në përgjithësi e veprës penale pa mbajtur këtu parasysh rrethanat të tilla, të cilat lidhen edhe me autorin e veprës penale dhe që janë veçori e individualizimit që bën gjykata. Me këtë lloj individualizimi gjykata konkretizon, brenda hapësirës që ajo disponon, llojin dhe masën e dënimit konkret, për një veprë që tashmë është kryer *“de facto”* dhe ndaj një subjekti të caktuar. Pra, me anë të këtij individualizimi kemi kalimin nga faza abstrakte e parashikimit të veprave penale dhe dënimeve përkatëse në rast të kryerjes së tyre, në një fazë më konkrete ku vepra penale është kryer dhe autori i saj ekziston dhe paraqet një rrezikshmëri të caktuar, e cila do të vlerësohet nga gjykata bashkë me rrethanat e tjera.

Bazuar në faktet dhe në rrethanat konkrete – **Neni 47 – 48 – 49 – 50 K.Penal**, Gjykata vlerëson dhe merr në konsideratë për të pandehurin **Albert Duka**:

- Rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, përhapja e saj në shoqëri;
- Nivelin dhe llojin e pasojës së ardhur;
- Rrezikshmërinë shoqërore të autorit të kryerjes së veprës penale:
- **I pandehuri** rezulton të jetë **i pa-dënuar më parë, pa asnjë rekord penal të mëparshëm.**;
- **I pandehuri** që në momentin e parë në të cilin është ndaluar, shoqëruar, dhe më pas arrestuar nga oficerët e policisë, gjithashtu gjatë gjithë fazës së hetimeve paraprake si dhe në gjykim, **nuk** ka shfaqur veprime kundërshtuese apo mosbindëse.
- **I pandehuri, si në hetim ashtu edhe gjatë gjyqimit të çështjes, para gjykatës, është** karakterizuar nga një sjellje shumë e qetë, korrekte dhe bashkëpunuese, në respektim të të gjitha procedurave ligjore përkatëse dhe organeve kompetente proceduese, duke treguar qëndrim pohues, pendues, i keq-ardhur për sa ka ndodhur, ka kërkuar mëshirë, duke premtuar se veprime të tilla nuk do të kryhen më kurrë nga ana e tij – Rrethanë lehtësuese kjo e parashikuar në **nenin 48 të Kodit Penal**.
- **I pandehuri** është hetuar në masën e sigurimit personal “arrest në burg” nga datat 06.09.2021 deri në datën 21.09.2021, datë në të cilën Gjykata e Apelit Tiranë e ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të “**arrest në shtëpi**” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale; Ndërsa me vendimin e datës 15.12.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të “Detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, masë të cilën i pandehuri e ka respektuar me rigorozitet dhe korrektësi absolute, duke vuajtur kështu në total, rreth **4 muaj burgim**.
- **I pandehuri** është paraqitur personalisht në secilën prej seancave, në gjykatë.
- **I pandehuri** ka kërkuar të gjykohej me formën e gjyqimit të posaçëm, gjykim të shkurtuar, duke i pranuar të gjitha faktet dhe aktet procedurale në gjëndjen e paraqitur nga ana e Prokurorit, e duke i hapur kështu udhë ekonomisë gjyqësore;
- **I pandehuri është beqar;**
- **I pandehuri, aktualisht është 44 vjeç;**
- **Arsim 8 vjeçar;**
- **I pandehuri është i papunë;**
- **I pandehuri, dhe familja e tij, nuk trajtohen me ndihmë ekonomike;**
- **I pandehuri** gëzon një reputacion dhe konsideratë positive në komunitet dhe në rrethin shoqëror ku ai dhe familja e tij jetojnë dhe bëjnë pjesë.
- **Sasia (jo e madhe) e bimës narkotike e cila rezultonte në fazë kultivimi.**
- **Nuk rezulton të ketë asnjë rrethanë rënduese e parashikuar nga neni 50 i Kodit Penal.**
- Gjykata në caktimin e llojit, si dhe të masës së dënimit merr në konsideratë të gjitha rrethanat e analizuara si më sipër, si dhe e mbështet vendim-marrjen e saj në nenet: **284/1 – 48 - 49 – 50 të Kodit Penal**.

Bazuar në faktet dhe në rrethanat konkrete – **Neni 47 – 48 – 49 – 50 K.Penal**, Gjykata vlerëson dhe merr në konsideratë për të pandehurin **Jashar Duka**:

- Rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, përhapja e saj në shoqëri;
- Nivelin dhe llojin e pasojës së ardhur;
- Rrezikshmërinë shoqërore të autorit të kryerjes së veprës penale:
- **I pandehuri** rezulton të jetë **i pa-dënuar më parë, pa asnjë rekord penal të mëparshëm.**;
- **I pandehuri** që në momentin e parë në të cilin është ndaluar, shoqëruar, dhe më pas arrestuar nga oficerët e policisë, gjithashtu gjatë gjithë fazës së hetimeve paraprake si dhe në gjykim, **nuk** ka shfaqur veprime kundërshtuese apo mosbindëse.
- **I pandehuri, si në hetim ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes, para gjykatës, është** karakterizuar nga një sjellje shumë e qetë, korrekte dhe bashkëpunuese, në respektim të të gjitha procedurave ligjore përkatëse dhe organeve kompetente proceduese, duke treguar qëndrim pohues, pendues, i keq-ardhur për sa ka ndodhur, ka kërkuar mëshirë, duke premtuar se veprime të tilla nuk do të kryhen më kurrë nga an e tij – Rrethanë lehtësuese kjo e parashikuar në **nenin 48 të Kodit Penal**.
- **I pandehuri** është paraqitur personalisht në secilën prej seancave, në gjykatë, ndonëse në një moshë mjaft të thyer, si dhe me problem shëndetësorë të shfaqura dhe të dukshme, sikurse për shëmbull vështirësia në të dëgjuar përgjatë seancës; ...
- **I pandehuri** ka kërkuar të gjykohet me formën e gjykimit të posaçëm, gjykim të shkurtuar, duke i pranuar të gjitha faktet dhe aktet procedurale në gjëndjen e paraqitur nga ana e Prokurorit, e duke i hapur kështu udhë ekonomisë gjyqësore;
- **I pandehuri** është hetuar në masën e sigurimit personal “arrest në burg” nga datat 06.09.2021 deri në datën 21.09.2021, datë në të cilën Gjykata e Apelit Tiranë e ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të “**arrest në shtëpi**” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale; masë të cilën i pandehuri e ka respektuar me rigorozitet dhe korrektësi absolute, duke vuajtur kështu në total, rreth 9 muaj **burgim**.
- **I pandehuri, është kyefamiljar,**
- **I pandehuri është i martuar,**
- Është baba i 3 fëmijëve;
- **I pandehuri, aktualisht është 63 vjeç;**
- **Arsim 8 vjeçar;**
- **I pandehuri është i papunë;**
- **I pandehuri, dhe familja e tij, trajtohen me ndihmë ekonomike;**
- **Bashkëshortja e tij, është në një gjëndje tepër të rënduar shëndetësore;**
- **Sasia (jo e madhe) e bimës narkotike e cila rezultonte në fazë kultivimi**
- **Nuk rezulton të ketë asnjë rrethanë rënduese e parashikuar nga neni 50 i Kodit Penal.**
- Gjykata në caktimin e llojit, si dhe të masës së dënimit merr në konsideratë të gjitha rrethanat e analizuara si më sipër, si dhe e mbështet vendim-marrjen e saj në nenet: **284/1 – 48 - 49 – 50 të Kodit Penal**.

Për sa më sipër, në analizë të të gjith rrethanave dhe fakteve të kryerjes së veprës penale, personalitetit të të pandehurit, Gjykata arrin në përfundimin se masa e dënimit e duhet të përputhet dhe t'i përgjigjet kërkesave të nenit 47 të K. Penal dhe parimit të ligjshmërisë.

Gjykata në caktimin e masës së dënimit mban parasysh faktin që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer” (**Vendimi i GJK nr. 47/2012, pg. 25**).

Vetë masa e dënimit penal, është në vetvete një “**parashikim**” nga ana e gjykatës, i kohës që konsiderohet e mjaftueshme për të arritur në riedukimin e të dënuarit, në raport kjo me rrezikshmërinë e veprës së kryer dhe të autorit të saj.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata, çmon të deklarojë fajtor të pandehurit, për kryerjen e veprës penale të “**Kultivimi i bimëve narkotike**” parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.

Meqënëse, gjykimi i kësaj çështjeje, u zhvillua në kushtet e nenit 403 - 405 e vijues të K.Pr.Penale, në caktimin e dënimit përfundimtar Gjykata merr në konsideratë aplikimin e nenit **406 të K.Pr.Penale**.

V **ALTERNATIVAT E DËNIMIT TË APLIKUESHËM**

Neni 59 Kodi Penal

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008;
ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017)

1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhëroj që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
2. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.
3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.
4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërme shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.
5. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Në respektim të plotë të kriterëve dhe kërkesave ligjore të parashikuara në **nenin 59 të Kodit Penal**, duke pasur parasysh **rrezikshmërinë e ulët të të pandehurve**, veprimet konkludente dhe sjelljen e tyre në tërësi, qoftë gjatë kryerjes së veprës penale, ashtu dhe në vijueshmëri, deri në përfundim të këtij procesi gjyqësor, sjelljen bashkëpunuese me autoritetet e procedimit penal; disponibilitetin e tyre, në raport me të gjitha procedurat ligjore përkatëse, faktin që të pandehurit **pranuan** kryerjen e veprës penale dhe **treguan pendim të thellë**, kërkoi **ndjesë dhe mëshirë** përpara gjykatës; duke marrë në konsideratë rrethanat **jo rënduese** në kryerjen e veprës penale, faktin që nga vepra penale nuk rezultoi të ketë ardhur asnjë pasojë konkrete, **Gjykata** urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin, me kusht që, gjatë kohës së provës, i pandehuri të mos kryejë asnjë veprë penale si dhe detyrohet të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës, duke zbatuar kushtet dhe detyrimet e caktuara nga Gjykata.

Neni 60 Kodi Penal

Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008; ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017)

I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
 2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.
 3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.
 4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.
 5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.
 6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
 7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.
 8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.
 9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
 10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.
 11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.
 12. T'i nënshtrohet një trajtimi, apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike.
- Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre.*

Detyrimet e parashikuara në pikat 11 dhe 12, të paragrafit 1, të këtij neni, caktohen vetëm me pëlqimin e të dënuarit.

Periudha për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet nga gjykata brenda periudhës të caktuar të provës.

Në zbatim të nenit 60/9 të Kodit Penal, i pandehuri detyrohet të mos shoqërohet me persona të dënuar.

Neni 61 Kodi Penal

Detyrimet e të dënuarit gjatë kohës së provës

Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar:

- a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
- b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e

vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, në zbatim të nenit 284/2 – 48 - 49 – 50 - 59 – 60 - 61- 62 të K. Penal, si dhe në zbatim të nenit 406, 379 – 384, 389/1 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Albert Duka**, për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*” parashikuar nga neni 284/1 Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.

Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e 1/3-ës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Albert Duka**, me **3 vjet e 4 muaj burgim**.

Në aplikim të **nenit 59 të Kodit Penal**, lidhur me pjesën e mbetur të pavaajtur të këtij dënimi penal, Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit **Albert Duka**, në provë për një periudhë prej **4 vjet**, me kusht që gjatë kohës së provës, i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta dhe sistematike me Zyrën e Shërbimit të Provës Tiranë.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Jashar Duka**, për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*” parashikuar nga neni 284/1 Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.

Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e 1/3-ës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Jashar Duka**, me **3 vjet e 4 muaj burgim**.

Në aplikim të **nenit 59 të Kodit Penal**, lidhur me pjesën e mbetur të pavaajtur të këtij dënimi penal, Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit **Jashar Duka**, në provë për një periudhë prej **4 vjet**, me kusht që gjatë kohës së provës, i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta dhe sistematike me Zyrën e Shërbimit të Provës Tiranë.

3. Në aplikim të nenit **60/9 të K.Penal**, urdhërohet i pandehuri të mos shoqërohet me persona të dënuar.
4. Në zbatim të **nenit 61 i K. Penal**, i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës, duke zbatuar kushtet dhe detyrimet e caktuara nga Gjykata.
5. Në zbatim të **nenit 61 të Kodit Penal**, i pandehuri detyrohet të marrë pëlqimin e shërbimit të provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës, apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.

1. **Afati i provës fillon nga e nesërmja shpalljes së këtij vendimi.**

6. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet zyrtarisht menjëherë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe Zyrës së Shërbimit të Provës, Tiranë.
7. Në aplikim të nenit 190/1 të K.Pr.Penale, bima narkotike e sekuestruar të asgjësohet.

8. Në zbatim të nenit 389/1 i K.Pr.Penale, Gjykata urdhëron heqjen e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur pranë policisë gjyqësore*” dhe “*Arrest në shtëpi*”, në ngarkim të të pandehurve Albert Duka dhe Jashar Duka.
9. Shpenzimet procedurale, si dhe ato gjyqësore në tërësi, i ngarkohen solidarisht të pandehurve.
1. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve, nga e nesërmeja e komunikimit të këtij vendimi.
1. **U shpall, sot në Tiranë, në datë 13.05.2022.**

SEKRETARE ORNELA ONJEA	GJYQTARE MIGENA LASKA
<p>Shpenzime gjyqësore</p> <p>Njoftime 2x150 300.00 Lekë</p> <p><u>Shpenzime te prokurorise</u> <u>4 000.00 Lekë</u></p> <p>Totali i shpenzimeve 4 300.00 Lekë</p>	